

Data 06.08.2025

PROCESVERBAL ARGUMENTIMI

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen, rehabilitimin dhe transferimin e segmentit rrugor “Milot-Balldre”

Vlera e Totale e parashikuar për Kontratën është 364,732,924 EUR pa TVSH. Në këtë vlerë përfshihen shuma e Vlerës së Projektimit, Vlerës së Operimit, vlerës së Mirëmbajtjes rutinë dhe kapitale.

- Vlera e parashikuar e Projektit është 3,650,964 EUR pa TVSH (Projektimi) plus 182,548,198 EUR pa TVSH (Ndërtim, rehabilitim) plus 10,122,482 EUR pa TVSH (Sistemi i Pagesës (toll)
- Vlera e parashikuar e Operimit është 84,979,849 EUR pa TVSH (Operimi)
- Vlera e parashikuar e Mirëmbajtje Rutinë dhe Kapitale është 83,431,431 EUR pa TVSH

Në bazë të Nenit 21, pika 2 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe Nenit 2, pika 2/c dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Autoriteti/Enti Kontraktor Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka hartuar procesverbalin për argumentimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në zbatim të Ligjit Nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar përpara shpalljes së procedurës së dhënies me koncesion/ PPP “Për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen, rehabilitimin dhe transferimin e segmentit rrugor “Milot-Balldre”, Autoriteti Kontraktues MIE ka dërguar studimin e fizibilitetit për vlerësim dhe miratim në Ministrinë e Financave. Ministria e Financave me shkresën nr. 13999/21 prot., datë 04.12.2024 ka miratuar studimin e fizibilitetit për dhënien me koncesion të këtij segmenti rrugor.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) Sigurimi i ofertës, sipas Shtojcës 3;
- b) Deklarate mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;
- c) Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 6;
- d) Përshkrimi i Ofertës i plotësuar dhe nënshkruar në mënyrë të duhur, sipas Shtojcës 1;
- e) Formular i vlerësimit për realizimin e punimeve sipas Shtojcës 7;
- f) Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenet 76, 82 dhe 83 të LPP dhe Nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Ofertuesi duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të konkurrimit dhe mban përsipër çdo rrezik që mund të ndodhë, sic parashikohet apo nënkuptohet në Kushtet e Kontratës.

2.2.1. Të gjithë Ofertuesit duhet të tregojnë një pozitë ekonomike e financiare që siguron financimin e zbatimit të qëllimit të Marrëveshjes së Konkensionit. Në mënyrë që një ofertues të kualifikohet, ai duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- a. Të dorëzojnë bilanci të tre viteve të fundit financiare ku të tregojnë se raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit në të paktën për dy bilance të njëpasnjëshme të jenë pozitive (>0).
- b. Kapitali i veta (totali i aktivitetit minus detyrimet) për vitin e fundit fiskal duhet të jetë jo më pak se 30% e vlerës së projektit siç tregohet në Pasqyrat Financiare të Audituar të vitit të fundit fiskal.
- c. Një xhiro mesatare vjetore të paktën 1 (një) nga 3 (tre) vite të fundit financiare (2022, 2023, 2024) minimalisht sa 10% e vlerës së kontratës.

2.2.2. Për qëllime të rasteve sipas 2.2.1 ofertuesi duhet të dorëzojë pasqyrat financiare të 3 (tre) viteve të fundit të cilat duhet të jenë:

- a. Të audituara nga auditues ligjor dhe të shoqëruara me shënime shpjeguese.
- b. Të publikuara (vendos adresën e sistemit elektronik të faqes në të cilën janë publikuar pasqyrat financiare) në përputhje me Ligjin e Shtetit ku ofertuesi ka selinë e tij.
- c. Në një nga monedhat e publikuara në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë

Mosplotësimi i këtyre kërkesave përben shkak për skualifikim të ofertuesit.

2.2.3. Ofertuesit duhet të paraqesin dokumente që dëshmojnë një marrëveshje të besueshme dhe të verifikueshme financiare për projektin, duke specifikuar qartë vlerën e financimit. Këto dokumente mund të jenë në formën e një ose më shumë letrash interesi për mbështetjen “në parim” të projektit, të lëshuara nga institucione financiare me reputacion të mirë, ku shprehet qartë angazhimi i tyre për financimin e projektit; dhe/ose një autorizim/letër angazhimi nga Bordi i Shoqërisë, apo nga një autoritet vendimmarrës i ngjashëm në nivel të lartë të Ofertuesit, për financimin e projektit nga burime të brendshme; si dhe prova të fondeve të disponueshme, ose një kombinim i këtyre dokumenteve.

2.2.4. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë plan biznesi për të gjithë periudhën ekonkesionit/ppp duke përfshirë të dhënat e kërkuara në dokumentet e tenderit. Plani i Biznesit duhet të hartohet në përputhje me pikat 3 e vijuese të nenit 7 të VKM nr. 575, datë 10.07.2013 “Për Miratimin e Rregullave për Vlerësimin dhe Dhënien me Koncesion/Partneritet Publik Privat” të ndryshuar, për aq sa është e aplikueshme.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar referuar vlerës së projektit dhe vlerës së kontratës së kësaj procedure, referuar Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin Publik”, të ndryshuar, dhe VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Përcaktimi i pikës (a) i referohet VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, të ndryshuar. Pasqyrat financiare me bilanc pozitiv paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri kapacitetet ekonomike dhe financiare të Ofertuesve.

Përcaktimi i pikës (b) i referohet Ligjit Nr. 162/2020, të ndryshuar dhe nenit VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, të ndryshuar. Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar i kërkuar, i dokumentuar me bilancet apo pasqyrat financiare, i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes ekonomike dhe financiare të Ofertuesve dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të Kontratës gjatë fazës së ndërtimit.

Përcaktimi i pikës (c) i referohet Ligjit Nr. 162/2020, të ndryshuar, dhe VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, të ndryshuar. Duke patur parasysh madhësinë dhe kompleksitetin e projektit, është kërkuar që vlera minimale e xhiros mesatare vjetore të paktën 1 (një) nga 3 (tre) vite të fundit financiare (2022, 2023, 2024) të jetë minimalisht sa 10% e vlerës së kontratës, kjo për të dëshmuar kapacitetin financiar të Ofertuesit, me qëllim përmbushjen me sukses të Kontratës gjatë fazës së Operimit dhe Mirëmbajtjes.

Përcaktimi i viteve të nevojshme për paraqitjen e bilanceve bëhet duke iu referuar Ligjit Nr. 162/2020, të ndryshuar dhe VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, të ndryshuar, dhe Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar, si dhe akteve nënligjore dhe udhëzimeve përkatëse.

Kriteret e vendosura janë në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare dhe kanë për synim garantimin e cilësisë së procedurës së dhënies me koncesion të segmentit rrugor Milot-Balldre. Këto kriteret nuk përjashtojnë apo diskriminojnë Operatorët Ekonomikë, përkundrazi ato kanë për qëllim të nxisin pjesëmarrjen e Operatorëve Ekonomikë me përvojë dhe kapacitete të larta, në mënyrë që të sigurohet realizimi me sukses i këtij projekti kompleks dhe shumë të rëndësishëm.

2.3 Kapaciteti teknik:

Ofertuesi (ose çdo anëtar i Bashkimit të Përkohshëm të shoqërive, kur ofertuesi është i tillë) duhet të plotësojë kërkesat teknike profesionale, si dhe duhet të zotërojë dhe demonstrojë në mënyrë të përmbledhur Eksperiencën referuar punës/shërbimeve që është angazhuar të kryejë.

Ofertuesi duhet të plotësojë Eksperiencën në Projektim, Ndërtim dhe Mirëmbajtje për Segmentin Rrugor Milot-Balldre, si dhe Kapacitetin Profesional në përputhje me dispozitat e mëposhtme:

2.3.1. Eksperienca në Projektim

Ofertuesi, ose në rast se Ofertuesi është një Bashkim i Përkohshëm i Shoqërive, anëtarët e tij që janë deklaruar si përgjegjës për realizimin e Projektimit, duhet që gjatë 5 (pesë) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, për të vërtetuar se kanë përvojën e duhur në projektimin e natyrës së objektit që prokurohet duhet të vërtetojnë se plotësojnë sa më poshtë vijon:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 10% e vlerës së përlogaritur të projektimit për objektin që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë:
 - kontratën dhe vërtetimet të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të saj, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit;
 - situacionet dhe faturat tatimore të shitjes (për të gjithë vlerën e kontratës), të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë:
 - situacionet dhe fatura tatimore të shitjes (për të gjithë vlerën e kontratës), të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
 - kontratën dhe vërtetime për përmbushjen me sukses të saj, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe Nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 10 % të vlerës së projektimit, për një objekt të vetëm (që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar) ose minimalisht sa dyfishi i vlerës së projektimit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Ofertuesi, ose në rast se Ofertuesi është një Bashkim i Përkohshëm i Shoqërive, anëtarët e tij që janë deklaruar si përgjegjës për realizimin e Projektimit, duhet të disponojnë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës bazuar në formatin e miratuar. Licenca profesionale e operatorëve ekonomikë e lidhur me ekzekutimin e shërbimeve të kontratës objekt prokurimi, duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- Kategoria 2.d Projektim peisazhi, sistemim sipërfaqja te gjelberta, lulishte e parqe

- Kategoria 4.i Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive, porte e aeroporte etj.
- Kategoria 4.j Projektimi i rrjeteve të telefonisë, citofonise, fonise, internetit, TV, Access kontrollit, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e detektimit të zjarrit.
- Kategoria 6.a Projektim rrugë lokale, rruge urbane dytësore dhe rruge interurbane dytësore.
- Kategoria 6.b Projektim rruge urbane kryesore dhe rruge interurbane kryesore.
- Kategoria 6.c Projektim Autostrada
- Kategoria 7.b Projektim ura dhe vepra arti mbi 10 m.
- Kategoria 7.c Projektim ura/viadukte me hapsira të mëdha drite, ura të varura, ura me sistem të pacaktuar statikisht dhe sisteme të tjera speciale.
- Kategoria 7.e Tunele rrugore-hekurudhore.
- Kategoria 8.a Rilevime Inxhinierike
- Kategoria 9.d Studim/Vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.
- Kategoria 9.e Studime e projekte hidrogjeologjike.
- Kategoria 10.e Kabina elektrike të rrjetit të shpërndarjes – linja të tensionit të ulët – mesëm
- Kategoria 11.a Sinjalistikë jondriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime.
- Kategoria 11.b Sinjalistike jondricuese në autostrada, rruge urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore dhe në degëzime me hekurudhën.
- Kategoria 11.d Sinjalistike ndriçuese në infrastrukturë.
- Kategoria 12.c Studime/ Vlerësime të sizmiologjisë inxhinierike për trojet ku do të ndërtohen objekte të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore të të gjitha llojeve, ura, tunele, viadukte etj.

Bazuar në Vendimin nr. 943, datë 28.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 759, datë 12.11.2014, "Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, subjektet fizike / juridikë të huaj duhet të aplikojnë për ekuivalentimin e licencës së huaj në Republikën e Shqipërisë. Kandidati/ofertuesi i huaj duhet të bëjë njehsimin e licencave profesionale të lëshuara nga vendi i origjinës për kategoritë e punimeve pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në Republikën e Shqipërisë (mosparaqitja e saj përbën kusht skualifikues).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), nenin 41, pika 4, gërma a) të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), si dhe Vendimin Nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të

projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Kategoritë e studim projektimit janë vendosur në përputhje me detyrat dhe objektivat e përshkruara te Studimi i Fizibilitetit.

Ofertuesi, ose në rast se Ofertuesi është një Bashkim i Përkohshëm i Shoqërive, anëtarët e tij që janë deklaruar si përgjegjës për realizimin e Projektimit, duhet të vërtetojë se disponojnë kualifikimet e duhura të stafit drejtues teknik të shoqërisë, të aftë për kryerjen e të gjitha shërbimeve sipas objektit të kësaj kontrate, si më poshtë:

- Drejtues projekti (Inxhinier Ndërtimi)
- Inxhinier Ndërtimi profili Strukturist.
- Inxhinier Ndërtimi profili Infrastrukturë e Transportit
- Inxhinier Elektrik
- Inxhinier Elektronik
- Inxhinier Hidroteknik
- Inxhinier Mjedisi
- Inxhinier Gjeoteknik
- Inxhinier Gjeodet/ Markshajder
- Inxhinier Gjeolog
- Inxhinier Mekanik

Për secilin pjesëtar të stafit kryesor të mësipërm duhet të paraqesë: kontratë pune, CV dhe licencat profesionale për projektim për objektin që prokurohet.

Argumentimi: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht, KDHK për vendosjen e stafit i është referuar detyrave dhe objektivave të përshkruara te Studimi i Fizibilitetit.*

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës. Nevoja për këta inxhinierë është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni në fushën e studim projektimit në ndërtim. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Ofertuesi, ose në rast se Ofertuesi është një Bashkim i Përkohshëm i Shoqërive, anëtarët e këtij Bashkimi që janë deklaruar përgjegjës për ndërtimin, për të vërtetuar se kanë përvojën e duhur në ndërtim, duhet të vërtetojnë se plotësojnë sa më poshtë:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 15% e vlerës së përlllogaritur për ndërtimin dhe sistemin e pagesës që prokurohet dhe që është realizuar

gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; ose

- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.2/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.2/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentet e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular Vlerësimi për realizimin e punimeve sipas Shtojcës nr. 7, shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar;
 - Faturat tatimore (për të gjithë vlerën e kontratës së sipërmarrjes);
 - Aktin e kolaudimit;

Shënim: Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Vërtetim i lëshuar nga subjekti privat shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Faturat tatimore (për të gjithë vlerën e kontratës së sipërmarrjes) të deklaruara në organet tatimore;
 - Akt kolaudimi objekti;

Shënim: Vërtetimi duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe Nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 15 % të vlerës së përlogaritur për ndërtimin dhe sistemin e pagesës që prokurohet (që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar), për një objekt të vetëm, ose

minimalisht sa dyfishi i fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë Autoritetin Kontraktor, se Operatorët Ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Ofertuesi, ose në rast se Ofertuesi është një Bashkim i Përkohshëm i Shoqërive, anëtarët e këtij Bashkimi që janë deklaruar përgjegjës për ndërtimin duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me VKM Nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” e ndryshuar. Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licenca profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë:

1	NP-1-G	Punime gjërmimi në tokë
2	NP-2-B	Ndërtime civile e industriale
3	NP-4-G	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale
4	NP-5-G	Punime nëntokësore, ura e vepra arti
6	NP-9-E	Punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime
7	NP-11-C	Ndërtimi për nënstacione, kabina e transformatorëve, linja e TN e të mesëm dhe shpërndarja e energjisë
8	NP-12-D	Punimet të inxhinierisë së mjedisit
9	NS.1 – D	Punime për prishjen e ndërtimeve
10	NS-6- E	Sinjalistika rrugore jondriçuese
11	NS-7-F	Barriera dhe mbrojtja rrugore
12	NS-9 – D	Punime strukturore speciale
13	NS-18-E	Punime topogjeodezike
14	NS-20-F	Shpime gjeologjike-inxhinierike, puse dhe shpime për ujë

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në Nr. 42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar, si dhe VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” e ndryshuar. Gjithashtu, të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, Ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, Neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane”.

Kategoritë e kërkuara janë përcaktuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1-G	Punime germimi në tokë	Punime germimi në trupin e rruges, në vepra arti të vogla, etj.	Mbi 800 mln	979,700,882
NP-2-B	Ndërtime civile e industriale	Godina e toll (5% e vlerës së parashikuar në studim fizibiliteti	21-50 mln	50,000,000
NP-4-G	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale	Përfshin gjithë punimet në rrugë dhe sistemin e toll.	Mbi 800 mln	19,033,936,471
NP-5-G	Punime nëntokësore, ura e vepra arti	Punime për ndërtimin e urave etj	Mbi 800 mln	1,439,699,957
NP-9-E	Punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime	Punime sisteme të drenimit	201-400 mln	313,832,060
NP-11-C	Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve, linja	Punime për linjat, fibrat etj	51-100 mln	77,784,748

	TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë			
NP-12-D	Punime të inxhinierisë së mjedisit	Punime mjedisore	101-200 mln	127,306,821
NS-1-D	Punime për prishjen e ndërtimeve	Punime për prishje të shtresave	101-200 mln	125,408,853
NS-6- E	Sinjalistika rrugore jondriçuese	Punime sinjalistike vertikale dhe horizontale	201-400 mln	226,384,531
NS-7-F	Barriera dhe mbrojtja rrugore	Vendosje guardrail	401-800 mln	606,713,863
NS-9-D	Punime strukturore speciale	Punime për pilotat	101-200 mln	167,229,516
NS-18-E	Punime topogjeodezike	Punime në trupin e rrugës, vepra arti, shtresa etj	201-400 mln	254'480'968
NS-20-F	Shpime gjeologjike-inxhinierike, puse dhe shpime për ujë	Shpime të parashikuara	401-800 mln	403,932,816

Personelin kryesor drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi, profili Strukturist
- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi profili Infrastrukturë e Transportit
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1(një) Inxhinier Elektrik
- 1(një) Inxhinier Gjeolog
- 1(një) Inxhinier Mjedisi
- 1(një) Inxhinier Gjeodet/ Markshajder
- 1(një) Inxhinier Mekanik

Për secilin pjesëtar të stafit kryesor të mësipërm duhet të paraqesë: CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe Nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për stafin drejtues teknik lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni

për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Inxhinierët janë përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të pasur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

Personelin mbështetës, si më poshtë:

- **1 (një) Inxhinier Ndërtimi**
- **1 (një) Inxhinier Ndërtimi, profili Strukturist**
- **1 (një) Inxhinier Ndërtimi profili Infrastrukturë e Transportit**
- **1(një) Inxhinier Elektronik**
- **1(një) Inxhinier Gjeolog**
- **1 (një) Inxhinier Gjeoteknik**
- **1(një) Inxhinier Gjeodet/ Markshajder**
- **1(një) Inxhinier Mekanik**

Për secilin pjesëtar të stafit mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë: kontratë pune e vlefshme, diplomë, librezë pune dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Personat e deklaruar në stafin kryesor nuk mund të jenë njëkohësisht pjesë e stafit mbështetës, dhe anasjelltas.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Nenit 39, pika 6/c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin mbështetës lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht 200 (dyqind) persona. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për muajin **Gusht 2025.**
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, për

muajin **Gusht 2025.**

Argumentim: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin cilësohet se: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit i parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohë është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomikë, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim **të paktën 200 persona**, duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t'i referohemi projektit, preventivit, matjeve përkatëse është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një kopje të Politikës së Përgjithshme të shoqërisë lidhur me Shëndetin, Sigurinë dhe Mjedisin (ShSM) si dhe të konfirmojë pajtueshmërinë e tyre me kërkesat e Certifikatës HSE OHSAS 18001:2007. Operatori ekonomik duhet të tregojë mënyrën se si është respektuar Politika e Shoqërisë lidhur me ShSM gjatë 3 (tre) viteve të fundit, për sa i përket aksidenteve, si dhe statistikave të incidenteve gjatë 3 (tre) viteve të fundit.

Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar / kualifikuar si më poshtë:

- 1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 1 (një) punonjës që disponon certifikatën si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237, datë 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” i ndryshuar dhe VKM-së nr. 312, datë 5.5.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” i ndryshuar.

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori duhet të paraqesë: Diplomë/Certifikatat e cituara më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të Nenit të 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të

Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Kërkesa e mësipërme mbështetet në Ligjin nr. 10237 datë 18.2.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" i ndryshuar dhe VKM nr. 312, datë 5.5.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", i ndryshuar si dhe Ligjit nr. 10431 datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" i ndryshuar.

Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312, datë 5.5.2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmën e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Operatori/ët ekonomik/ë që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentet përkatëse lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikohet në legjislacionin në fuqi. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Ofertuesi (zbatuesi i punimeve) duhet të paraqesë një kopje ose përshkrim të planit të shoqërisë lidhur me Sigurimin e Cilësisë dhe Kontrollin e Cilësisë.

Ofertuesi (zbatuesi i punimeve) duhet të konfirmojë se vepron në përputhje me të gjitha kërkesat dhe standardet ISO. Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me Standardet e mëposhtme :

ISO 9001:2015 Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë

ISO 14001:2023 Sistemet e Menaxhimit Mjedisor

ISO 45001:2023 Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë

ISO 39001 - 2012 Menaxhimi i Sigurisë së Trafikut Rrugor

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, ku cilësohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.